

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr. 1773/16

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DEVIZIONI PENAL në përbërje me gjyqtarin e vetëm gjykues Rrustem Begolli dhe zyrtaren ligjore Sanije Troshupa, në lëndën penale kundër të pandehurit G.B për veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK_së, sipas akuzës të PTHDP-së në Prishtinë PP.II.nr. 2247/14 dt. 04.04.2016 duke vendosur lidhur me Kërkesën e PTH në Prishtinë për dhënien e urdhërit ndëshkimor me dt. 27.04.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e PTHDP-së në Prishtinë PP.II.nr., 2247/14 dt. 04.04.2016 dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

G.B, nga i ati M, i lindur më *data e lindjes*, me vendbanim në rrugën "...", nr..., në P, me profesion ekonomist, me nr.personal *numer personal* me nr.tel. **0./...-...** Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORË

SEPSE: Me dt. 08.03.2014, rreth orës 16:50, përderisa i pandehuri ishte duke e drejtuar automjetin e tipit "V P ..", me targa regjistrimi ..-...-..., ngjyrë e kaltër, në parkingun e qendrës tregtare ETC-së, në Fushë Kosovë , ka rrezikuar jetën e njerzëve dhe ka dëmtuar jetën e njeriut, në atë mënyrë që, nga pakujdesia ka vepruar në kundërshtim me nenin 42.1 të LSKRR-e, ngase shpejtësinë e lëvizjes nuk ia përshtatë kushteve dhe gjendjes së rrugës ashtu që, më tu kyçur në rrugën kryesore përkatësisht , në udhëkryqe të drejtimit për në Fushë Kosovë, nuk ka respektuar shenjën horizontale në rrugë që obligon kthim në të djathtë si dhe nuk ka respektuar përparësinë e kalimit të krahut të djathtë, për çka me pjesën e parë të automjetit e godet në pjesën e anës së majtë automjetin e tipit "C .", ngjyrë e gjelbër, me targa të regjistrimi ..-...-..., që e drejtonte i dëmtuari N.M, i cili posa ishte kyçur në udhëkryq të rrugëve të parkingut të ETC-së, me ç'rast si pasojë për veç dëmeve materiale në automjete sipas ekspertizës mjeko ligjore i dëmtuari pëson lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme në shëndet,

- me këtë ka kryer veprën penale **Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së .**

Andaj gjykata në bazë të neneve 41, 43, 46, të KPRK, si dhe neneve 365 e 495, të KPP të Republikës së Kosovës, të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Të pandehurit G.B dënohet në shumë nga **200 (dyqind euro) €**, të cilin dënim, është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata të njëjtin do ta ekzekutoj duke i caktuar nga një ditë burgimi për 20 (njëzet) € të gjobës.

I pandehuri obligohet të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë për ekspertizën e komunikacionit shumë prej **40.88 €** dhe ekspertizën mjeko-ligjore në shumë prej **20.00 €**, ndërsa në emër të paushallit gjyqësorë do të paguaj shumë prej **20 (njëzet) €**, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarit **N.M**, me vendbanim në fshatin G, Komuna F K, me nr.tel. 0./...-... dhe 0./...-... për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest civil.

A R S Y E T I M

Prokuroria Themelore në Prishtinë me akuzën PP.II nr. 2247/14 dt. 04.04.2016 e ka akuzuar të pandehurin G.B për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe njëkohësisht ka kërkuar që ndaj të pandehurit të shqiptohet Urdhëri Ndëshkimor-dënim me gjobë për veprën e cekur penale.

Në kuptim të nenit 493 të KPPRK, parashihet se për veprat penale për të cilat parashikohet dënim me gjobe ose burgim deri në tre vite, për të cilat prokurori i shtetit është informuar se në bazë të provave të besueshme nga kallëzimi penal, prokurori i shtetit mund të kërkoj me aktakuzë që gjykata të jep urdhër ndëshkimor në të cilin do të shqiptoj dënim përkatës pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor.

Gjyqtari i vetëm gjykues me rastin e shqyrtimit paraprak të kësaj çështje penale-juridike e duke i vlerësuar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës si: mendimi i ekspertit mjeko-ligjor Dr. F.B i dt. 08.04.2016, mendimi i ekspertit të komunikacionit B.S i dt. 03.06.2015 ndëshkimor ku të pandehurin e shpalli fajtor dhe e gjobiti si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjyqtari i vetëm gjykues me rastin e shqyrtimit të kësaj çështje penalo –juridike në kuptim të nenit 493 të KPPRK -së gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPK- së dhe pranoj Kërkesën për dhënën e urdhërit ndëshkimor .

Vendimi mbi obligimin e të pandehurit që të paguaj paushallin gjyqësor bazohet me nenin 450 të KPPK-së

Vendimi mbi realizimin e kërkesës pasurore-juridike u muarr në bazë të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPK së

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

P.nr. 1773/16 me dt. 27.04.2017

Zyrtare Juridike
Sanije Troshupa

Gj y q t a r i,
Rrustem Begolli

KËSHILLA JURIDIKE: I pandehuri ose mbrojtësi i tij në afat prej 8 ditëve pas pranimit të këtij aktgjykimi-Urdhëri Ndëshkimor, mund të paraqesin kundërshtim me shkrim ose me gojë.